

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“KONOR FRUITS “ SHPK

Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot më datë 15.11.2022, ne te nenshkruarit:

1. **Arben Kovaçi**, i datëlindjes 20.04.1980, lindur ne Tirane dhe banues ne Durres, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi I00420259J

themelojme një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin :

“KONOR FRUITS “ SHPK

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

Neni 2: Selia

Lagjja 14, Rruga Bajram Tusha, Zona Kadastrale 8515, Objekt me Nr. Pasurise 5/1744, Shkozet, Durres

Shoqeria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqiperise si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

Neni 3: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Aktivitet ne fushen e bujqesise dhe blegtorise. Import-eksport, tregtim dhe prodhim te produkteve e nenprodukteve bujqesore, blegtorale, agroushqimore, te pemeve frutore, fruta-perime, bime medicinale, te farerave e fidaneve, lendeve te para per bujqesine e blegtorine, krijimin e fermave agröblegtorale, ,mbareshtim

dhe rritje kafshesh e shpendesh, etj. Kultivim dhe perpunim produktesh e nenproduktesh bujqesore e blegtorale.

- Import- eksport, tregtim mallra te ndryshme industriale, pajisje makineri bujqesore, pjese kembimi, etj.
- Veprimtari ne fushen e ndertimit dhe rikonstruksionit te objekteve civile, turistike, shëndetsore, shoqërore, kulturore, tregtare, sportive, industriale, vepra kullimi, ujitje, rrugë, kanalizime, punime infrastrukture, ndertime rruges dhe autosrtrdash, asistencë dhe ekspertizë teknike. Punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge, ndertim mbi shtresa rrugore. Ndertim ura dhe vepra arti. Ndertime ujesjellesa dhe kanalizime,kanale e impiante vaditese. Germime dheu me punime eventuale murature e betonarme. Punime karpentierie druri. Punime karpenterie metalike, etj.
- Transport kombetar dhe nderkombetar mallrash te ndryshme.
- Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te çdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj(sipas nenit 7 te Ligjit nr.9901,dt.14.04-08).

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5: Kapitali

Kapitali i shoqërisë është **10.000 (dhjetemije)** Lekë, i ndarë në 1 kuote.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Arben Kovaçi, është zotërues i 1 kuote, me 100% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vleren 10.000 leke.

Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Arben Kovaçi**, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

Neni 7: Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 8: Dispozitat e fundit

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Shoqërisë

Arben Kovaçi

ARBEN KOVAÇI

